



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË



SHTOJCA 1.23

Rregullore e Mobiliteteve



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "FAN S. NOLI"



RREGULLORE
E SHKËMBIMIT TË STAFIT DHE STUDENTËVE
HARTUAR NË KUADËR TË
STRATEGJISË SË NDËRKOMBËTARIZIMIT TË
UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI"

(Miratuar me vendimin nr. 149, datë 18.10.2022,
të Senatit Akademik, Universiteti "Fan S. Noli")

KRYETARI I SENATIT

REKTORI
Prof. dr. Dhimitri Bello





Neni 1 Universiteti "Fan S. Noli" – informacion i përgjithshëm

Lloji i institucionit: Institucion publik i arsimit të lartë

Fushat e studimit: Bujqësi, edukim, gjuhët, biznes, shkencat natyrore dhe shkencat humane

Fakultetet: Fakulteti i Bujqësisë, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, Fakulteti i Ekonomisë, Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Humane

Studimet: Studimet në Universitet organizohen në tre cikle studimi, respektivisht: programe "Bachelor" (180 kredite), programe "Master Profesional" (60/120 ECTS), programe "Master i Shkencave" (120 kredite), programe studimore dyvjeçare të trajnimit profesional (120 ECTS) dhe 1 program studimi Phd.

Fushat e kualifikimit: Programet ofrojnë kualifikim në fusha studimi sipas **Standardeve Ndërkombëtare të Klasifikimit të Fushave të Arsimit, Kërkimit dhe Trajnimit** (miratuar nga UNESCO, Institute for Statistics (2013)

<http://uis.unesco.org/sites/default/files/documents/international-standard-classification-of-education-fields-of-education-and-training-2013-detailed-field-descriptions-2015-en.pdf>), si vijon:

- 01 Edukim;
- 02 Arte dhe Shkenca Humane;
- 04 Biznes, Administrim dhe Ligje;
- 05 Shkenca të Natyrës, Matematikë dhe Statistikë;
- 06 Teknologji Informacioni dhe Komunikimi (TIK);
- 07 Bujqësi;
- 08 Shëndeti dhe Mirëqenia;
- 10 Shërbime.

Neni 2 Qëllimi i shkëmbimeve studimore

Universiteti lidh marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera të arsimit të lartë, kombëtare dhe ndërkombëtare, për një ndërveprim më të mirë arsimor dhe kërkimor shkencor. Ai është pjesëmarrës aktiv i programeve evropiane Erasmus +, CBHE, CEPUS dhe Erasmus + Mobility Projects.

Universiteti nxit promovimin e ofertës së tij akademike si një prioritet i rëndësishëm kombëtar, i pasqyruar në Planin e tij Strategjik të Zhvillimit, nëpërmjet mobilitetit akademik, ndërkombëtarizimit dhe rritjes së performancës akademike. Ai gjithashtu fokusohet në:

- 2.1 Përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies duke përfitur nga metodologji të reja, si dhe duke inkurajuar kualifikimin e stafit akademik në zhvillimin e aftësive të tyre mësimore.
- 2.2 Përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit, rezultateve të të nxëniet dhe profileve të të diplomuarve në raport me nevojat e institucionit dhe shoqërinë.
- 2.3 Mbështetjen e kërkimit bazë dhe stimulimin në fushën e kërkimit për të kontribuar në zhvillimin e shoqërisë dhe rritjen akademike të stafit dhe studentëve.
- 2.4 Rritjen e rezultateve të kërkimit në Universitet në një kontekst ndërkombëtar
- 2.5 Rritjen dhe promovimin e stafit në një rrjet ndërkombëtar akademik.

Përfitimet akademike të Universitetit në kuadër të marrëveshjes dhe angazhimit në mobilitet:

- 2.6 Rritja e mundësive të ndërkombëtarizimit për ofertën akademike.
- 2.7 Promovimi i kualifikimit dhe përvojës së personelit akademik.
- 2.8 Shkëmbimi i përvojës mësimore dhe mundësive kërkimore.
- 2.9 Krijimi i rrjetit akademik të komunikimit (ngjarjet dhe publikimet e zakonshme akademike).
- 2.10 Rritja e mundësive për mobilitetin e studentëve dhe lehtësimi i aksesit të tyre në arsimin dhe kurrikulat evropiane.
- 2.11 Përmirësimi i rezultateve të të nxëniet të kurrikulës dhe metodologjive të mësimdhënies.

Neni 3

Objekti dhe qëllimi i rregullores

- 1- Kjo Rregullore synon organizimin dhe zbatimin e veprimtarive të Universitetit në bazë të marrëveshjeve të drejtpërdrejta bilaterale, angazhimeve ndërkombëtare të tij në programin Erasmus + dhe programe të tjera ndërkombëtare.
- 2- Menaxhimi administrativ i veprimtarive kryhet nga zëvendësrektori përgjegjës për aktivitetet ndërkombëtare dhe veprimtaritë administrative realizohen në bashkëpunim me specialistët e Sektorit të Projekteve dhe Kërkimit Shkencor.
- 3- Universiteti zbaton dhe respekton parimet e vendosura në traktatet ndërkombëtare duke siguruar qasje të barabartë dhe mundësi për lëvizje të të gjithë pjesëmarrësve, mosdiskriminim dhe bashkëpunim në frymën e politikës së ndërkombëtarizimit të Universitetit.

Neni 4

Roli i projekteve në zbatimin e Strategjisë së Ndërkombëtarizimit të Universitetit



- 1- Bashkëpunimi ndërkombëtar i Universitetit kryhet në dy forma kryesore:
 1. Njëpërmjet angazhimeve të drejtpërdrejta bilaterale dhe ndërkombëtare të Universitetit.
 2. Njëpërmjet programit Erasmus + dhe programeve të tjera evropiane.

- 2- Marrëveshjet e drejtpërdrejta bilaterale direkte dhe angazhimet ndërkombëtare të Universitetit synojnë:
 1. Anëtarësimin në shoqatat botërore, evropiane dhe ballkanike të universiteteve dhe pjesëmarrje në aktivitetet e tyre.
 2. Pjesëmarrjen në aktivitete shkencore ndërkombëtare (kongrese, konferenca, simpoziume, seminare, sesione, etj.)
 3. Shkëmbimin e grupeve të studentëve për kryerjen e praktikave, ekspeditave, seminareve të specializuara universitare, etj.
 4. Shkëmbimin e stafit drejtues për krijimin e bashkëpunimit.
 5. Shkëmbimin e pedagogëve për mësimdhënie dhe veprimtari kërkimore shkencore.
 6. Shkëmbimin e personelit administrativ në fusha të ndryshme të shërbimeve administrative.
 7. Shkëmbimin e studentëve.
 8. Forma të tjera të aktiviteteve të firmosura në marrëveshjet e brendshme (zbritje për përdorimin e shërbimeve, hyrje falas në vendet historike, përdorimi i objekteve, etj.).

- 3- Veprimtaritë e përmendura më poshtë do të zbatohen njëpërmjet programit Erasmus+ dhe programeve të tjera evropiane:
 1. Projektet e mobiliteteve Erasmus +, veprimi KA1 me vendet e programit: shkëmbimet e studentëve për studime dhe trajnime; shkëmbimet e stafit për mësimdhënie; shkëmbimet e stafit për trajnim.
 2. Projektet Erasmus +, veprimi KA1 për zhvillimin e programeve të përbashkëta Master.
 4. Projektet Erasmus +, veprimi KA2 për partneritete strategjike dhe ndërtimin e kapaciteteve.
 5. Projektet Erasmus +, veprimi KA3 për të mbështetur reformën e politikave dhe sportin.
 6. Projekte në kuadër të programeve të tjera evropiane.

Neni 5

Sektori i Bashkëpunimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë: detyrat dhe përgjegjësitë

Sektori i Bashkëpunimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë ka përgjegjësitë e mëposhtme:

1. Planifikon, organizon, zhvillon dhe raporton mbi veprimtarinë ndërkombëtare të universitetit.
2. Koordinon shkëmbimin akademik në të gjitha programet e bashkëpunimit të brendshëm.
3. Vendos kontakte, mbështet përfundimin dhe zbatimin e marrëveshjeve për bashkëpunim akademik me institucione të huaja shkencore dhe arsimore.
4. Ndihmon në përshtatjen e plotë ose të pjesshëm të studentëve të huaj, doktorantëve dhe pasuniversitarëve.
5. Shpërndan informacionin hyrës në të gjitha njësitet e Universitetit.
6. Përditëson informacionin në faqen e internetit në lidhje me veprimtarinë ndërkombëtare.
7. Administrinistron veprimtarinë e Universitetit në lidhje me programet ndërkombëtare evropiane për shkëmbimin akademik të studentëve, stafit akademik dhe stafit administrativ dhe programeve të tjera ndërkombëtare me vendet nga Bashkimi Evropian dhe jashtë tij.
8. Administron dhe koordinon aktivitete dhe dokumentacion për lëvizjen studentore hyrëse dhe dalëse, për studime, të financuar nga programet arsimore evropiane përmes partneritetit me universitete të huaja.
9. Organizon kurrikulat e specializuara - modulet e studimit për studentët hyrës.
10. Promovon programet dhe thirrje përkatëse me staf dhe studentë.
11. Përgatitja e dokumenteve të brendshme administrative për qëllime të akreditimit dhe monitorimit pas akreditimit dhe kontrollit dhe mirëmbajtjes së bazave të të dhënave me të dhënat e personave që kanë marrë pjesë në mobilitet.
12. Kujdeset dhe koordinon aplikimet për: marrjen e vizave, akomodimin, etj., të aplikantëve hyrës dhe dalës në Universitet.

Neni 6

Pjesëmarrja në mobilitet, qëllimi dhe efektet e tij

1. Çdo mobilitet në Universitet zhvillohet mbi bazën e natyrës dhe kuotave të dakordësuara në marrëveshjet ndërinstitucionale të nënshkruara paraprakisht.
2. Shkëmbimi i stafit dhe studentëve syon:
 - a. Promovimin e bashkëpunimit që çon në rezultate të qëndrueshme për Universitetin.

- b. Mbështetjen e pjesëmarrjes së stafit dhe studentëve në aktivitetet e pas-mobilitetit.
- c. Përdorimin e rezultateve të këtyre projekteve për të rritur ndikimin mbi individët dhe institucionet në një kontekst më të gjerë akademik.



Neni 7

Kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së mobiliteteve student dhe staf

- Thirrja për mobilitet përpilohet dhe përfshin kriteret e mëposhtme të vlerësimit:
 - Mobiliteti për stafin akademik: fusha e studimit, përvoja akademike, niveli dhe kualifikimi i studimit, kompetenca gjuhësore, letra motivuese dhe plani/programi i mobilitetit për mësimdhënie, plani i shpërndarjes së mobilitetit.
 - Mobiliteti për stafin administrativ: fusha e mobilitetit, përvoja akademike, kompetenca gjuhësore, letra e mbështetjes, shpërndarja e planit të mobilitetit në universitet.
 - Mobiliteti për studentët: fusha e mobilitetit, niveli i studimit, programi mësimor, kompetenca gjuhësore, letra e mbështetjes, plani i shpërndarjes së mobilitetit.
- Komisioni Përzgjedhës krijohet me urdhër të Rektorit.
- Komisioni Përzgjedhës shqyrton dhe vlerëson propozimet.
- Procesverbali përfundimtar i Komisionit Përzgjedhës miratohet nga Rektori.
- Kandidaturat e përzgjedhura përcillen në Universitetin pritës të shoqëruara me periudhën e mobilitetit, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me aplikimin (sipas procedurave të kërkuara nga universiteti pritës).
- Pas miratimit, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë kryen koordinimin e procedurave dhe dokumentacionit për mobilitet.

Neni 8

Sistemi i vlerësimit për mobilitetet e studentëve

Ekuivalentimi i periudhave të studimit kryhet sipas sistemit të vlerësimit, i cili paraqitet në tabelën e mëposhtme:

PIKËT	NOTA	ECTS (nota)	Përshkrimi
1-39	4	F	Dobët
40-50	5	F+	Dobët
51-60	6	E	I kënaqshëm
61-70	7	D	I kënaqshëm
71-80	8	C	Mirë
81-90	9	B	Shumë mirë
91-100	10	A	Shkëlqyeshëm

Neni 9

Rregullat për zbatimin e mobilitetit studentor

1. Në periudhën para mobilitetit, koordinatori akademik dhe studenti përgatisin marrëveshjen mësimore për studime / praktikë në të cilën përshkruajnë aktivitetet e planifikuara në institucionin pritës. Marrëveshja mësimore duhet të korrespondojë sa më shumë që të jetë e mundur me planin e studimit të studentit në të dy insitucionet. Në mbështetje të saj vihet edhe Katalogu i Lëndëve Erasmus+.
- (1) Studentët e përfshirë në mobilitet përjashtohen nga tarifat për: shkollimin, regjistrimin, provime, aksesin në laboratorë dhe biblioteka, për periudhën e mobilitetit, kur kjo periudhë është më tepër se tre muaj.

Në periudhën *gjatë mobilitetit*, përmes komunikimeve me Koordinatorin e Erasmus +, Universiteti qëndron në kontakt me studentët, të cilët studiojnë jashtë vendit, për t'u koordinuar me plotësimin e marrëveshjes mësimore dhe çdo nevojë tjetër të studentëve. Në rast mospërputhjeje të theksuara, mësuesi drejtues i disiplinës përcakton detyra shtesë (raport, konsultime etj.) për marrjen e krediteve të nevojshme. Kur nuk është dhënë provim për një disiplinë të caktuar në universitetin pritës, studenti ka të drejtën e shlyerjes së provimit për lëndën ekuivalente në universitetin e origjinës. Studentët Erasmus+ regjistrohen në vitin e ardhshëm të studimeve në UNIKO, nëse kanë plotësuar numrin e duhur të krediteve sipas Nenit 106 të Rregullores së organizimit dhe veprimtarisë mësimore, kërkimore-shkencore të Universitetit.

- (2) Studenti, i vlerësuar mbetës në dy sezonet e rregullta të provimeve (të dimrit dhe të vjeshtës), ka të drejtë të përdorë të gjitha datat e shpallura nga njësia kryesore në sezonin e vjeshtës.
- (3) Për të kaluar në vitin e dytë, (semestri i tretë), studenti duhet të ketë përfituar minimumi 20 kredite. Për të kaluar në vitin e tretë (semestri i pestë), studenti duhet të ketë përfituar minimum 60 kredite nga viti i parë dhe i dytë i programit të studimit.
- (4) Ridhënia e provimeve për lëndët (modulet) e pashlyera, lejohet gjatë vitit në vazhdim, në sezonet e shpallura të provimeve (tri herë në vit) ose deri në vitin e fundit të studimeve.
- (5) Për të kaluar në semestrin e parë të vitit të dytë, studenti që ndjek studimet në ciklin e dytë, "Master Profesional" me më shumë se 60 ECTS, duhet të ketë përfituar minimum 45 kredite.
- (6) Studenti i vitit të fundit, i cili, në përfundim të provimeve të vitit të tretë rezulton me detyrime mësimore, i shlyen ato në sezonin e vjeshtës dhe diplomën e mbron në këtë sezon.
- (7) Studentit përsëritës i njihen të gjitha detyrimet e shlyera, por duhet të shlyejë detyrimet e reja, që lindin për shkak të ndryshimeve që mund të jenë bërë në planin mësimor të programit të studimit.
- (8) Studenti me bursë humbet të drejtën e saj për vitin që përsërit.

Neni 10

Promovimi i përvojës së mobilitetit

Sipas marrëveshjeve të drejtpërdrejta bilaterale dhe në përputhje me angazhimet ndërkombëtare të Universitetit, Zyra e Projekteve dhe Marrëdhënieve me jashtë është e përfshirë në aktivitetet e mëposhtme:



1. Planifikon, organizon, zhvillon dhe raporton mbi veprimtarinë ndërkombëtare të universitetit.
2. Koordinon shkëmbimin akademik në të gjitha programet e bashkëpunimit të brendshëm.
3. Vendos kontakte, kryen veprimtari parakontraktore, mbështet përfundimin dhe zbatimin e marrëveshjeve për bashkëpunim akademik me institucione të huaja shkencore dhe arsimore.
4. Kryen shkëmbimin e literaturës arsimore dhe shkencore.
5. Ndhmon në trajnimin e plotë ose të pjesshëm të studentëve të huaj, doktorantëve dhe pasuniversitarëve.
6. Organizon takimin e ambasadorëve dhe përfaqësuesve të institucioneve të ndryshme nga vendi dhe jashtë vendit;
7. Koordinon dhe organizon veprimtari kërkimore-shkencore dhe ngjarje kulturore.
8. Shpërndan informacionin hyrës në të gjitha njësitë e Universitetit (njoftime për bursa, konkurse, kurse gjuhe, specializime, etj.).
9. Siguron dhe parashikon marrëveshje të bashkëpunimit të brendshëm (marrëveshje me institucione kulturore, institucione kërkimore-shkencore dhe struktura administrative).
10. Përditëson informacionin në faqen e internetit në lidhje me veprimtarinë ndërkombëtare.

Neni 11

Kjo rregullore hyn në fuqi duke filluar nga viti akademik 2021-2022.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 495 prot

Korçë, më 18 / 03 / 2022

VENDIM

Nr. 149, datë 18.03.2022

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË SHKËMBIMIT TË STAFIT DHE
STUDENTËVE HARTUAR NË KUADËR TË STRATEGJISË SË
NDËRKOMBËTARIZIMIT TË UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI"

Mbështetur në ligjin Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 1, gërma d), si dhe në Statutin e Universitetit neni 18, pika 6, Senati Akademik, në mbledhjen online të datës 18.03.2022,

VENDOSI:

1. Të miratojë "Rregulloren e shkëmbimit të stafit dhe studentëve hartuar në kuadër të strategjisë së ndërkombëtarizimit të universitetit "Fan S. Noli", sipas materialit bashkëngjitur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT
REKTORI
Prof. dr. Dhimitri Bello



